



## **VENDIMI MBI PRANUESHMËRINË DHE MERITAT E LËNDËS**

**Data e miratimit: 16 shtator 2021**

**Nr. i lëndës: 2018-01**

**Y.B. 2**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut (Paneli) i mbledhur më 16 shtator 2021, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Anna AUTIO, kryesuese  
Z. Alexander FASSIHI, anëtar

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019.

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURA PRANË PANELIT**

1. Kjo ankesa është regjistruar më 20 shkurt 2018.
2. Me letrën e datës 6 nëntor 2018, Paneli informoi përfaqësuesin e ankuesit se shefi i Misionit ("ShM") të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX-i Kosovë ("Misioni") ishte informuar se ky rast ishte regjistruar.
3. Më 22 mars 2019, Paneli ia komunikoi ankesën ShM-së, duke e ftuar Misionin që të paraqesë vërejtje me shkrim mbi çështjet e ngritura në ankesë jo më vonë se data 3 maj 2019.
4. Përmes postës elektronike të datës 19 prill 2019, Misioni kërkoi një zgjatje të afatit për të paraqitur vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës. Përmes postës elektronike të datës 25 prillit 2019, Paneli e zgjati afatin deri më 3 qershor 2019.

5. Përmes postës elektronike të datës 30 maj 2019, Misioni informoi Panelin se kërkonte informacion shtesë para se t'i përfundonte vërejtjet e tij. Në veçanti, Misioni i kërkoi Panelit që të ftojë ankuesin të ofronte dokumentet e mëposhtme:
  - a. Transkriptin e plotë në gjuhën angleze dhe shqipe i transmetimit "*Drejtësia në Kosovë*" u transmetua më 2 shkurt 2018, ku thuhet se transkripti i ofruar nga ankuesi nuk kishte përfshirë pyetjet e bëra nga gazetari prokurorit të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK ) dhe ishte vetëm në anglisht; dhe
  - b. Artikullin e plotë nga revista "*Slobodna Bosna*", e cila përmban intervistën e dhënë nga prokurori i PSRK-së më 7 shkurt 2018, ku Misioni deklaroi se artikulli është cituar disa herë nga ankuesi, por nuk ishte dorëzuar forma me shkrim në dosje.
6. Me letrën e datës 13 qershor 2019, ankuesit iu kërkua të siguronin informacion shtesë siç kërkohet nga ShM-ja. Ankuesi u ftua t'i ofronte këto dokumente deri më datën 14 korrik 2019.
7. Më 14 korrik 2019, ankuesi kërkoi një zgjatje të shkurtër të afatit. Paneli e zgjati afatin deri më 15 gusht 2019.
8. Më 30 korrik 2019, ankuesi dorëzoi dokumentet shtesë të kërkuara.
9. Me letrën e datës 5 gusht 2019, Paneli dorëzoi dokumentet shtesë tek ShM-ja dhe ftoi Misionin që të japë komentet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e çështjeve të ngritura në ankesë deri më 16 shtator 2019.
10. Përmes postës elektronike të datës 3 mars 2020, Misioni tregoi se kishte vendosur t'i jepte përparësi paraqitjes së vërejtjeve të tij mbi pranueshmërinë dhe/ose meritat në rastet e pazgjidhura që datojnë që nga viti 2016, para se të vazhdonte me rastet pasuese.
11. Përmes postës elektronike të datës 12 mars 2020, Misioni informoi Panelin se numri i ankesës 2018-01 ishte "nën shqyrtim" nga Zyra e Misionit për të Drejtat të Njeriut dhe Çështje Ligjore.
12. Më 21 mars 2021, ShM-ja paraqiti vërejtjet e tij mbi pranueshmërinë dhe meritat e ankesës.
13. Më 31 mars 2021, vërejtjet e ShM-së iu dërguan ankuesit, të cilit iu dha afat deri më 31 maj 2021 për të bërë ndonjë parashtrim të mëtejshëm në përgjigje të asaj letre.
14. Më 31 maj 2021, përfaqësuesi i ankuesit konfirmoi me telefon se ata nuk kishin ndërmend të jepnin ndonjë përgjigje të mëtejshme.

## II. FAKTET

15. Ankuesi është banor i Bosnjës dhe Hercegovinës.
16. Më 4 korrik 2014, një prokuror i EULEX-it në PSRK ngriti aktakuzë ndaj N.K. në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Ai u akuzua për krim të organizuar, vrasje të rëndë dhe vepra të ndryshme penale në lidhje me drogë, të cilat dyshohet se kishin ndodhur në Bosnjë dhe Hercegovinë.

17. Emri i ankuesit u shfaq në aktakuzë. Në veçanti, u tha se i akuzuari N.K. “në bashkëkryerje” me ankuesin dhe disa persona të tjerë,

*“organizoj, themeloj, mbikëqyri, menaxhoi dhe/ose drejtoi këtë Grup Kriminal të Strukturuar dhe të Organizuar (GKO) ose mori pjesë aktive në këtë GKO, duke e ditur se pjesëmarrja e tij do të kontribuojë në kryerjen e krimit të rëndë të Vrasjes së Rëndë ndaj shefit të bandës rivale. [RD] (...)”.*

18. Aktakuza më tej parashtroi se N.K. kishte,

*“ndjekur, një numër takimesh me [ankuesin dhe persona të tjerë], në Bosnjë dhe Hercegovinë. Pjesëmarrësit e këtyre takimeve formuan një grup kriminal të organizuar dhe të strukturuar për të planifikuar, komplotuar dhe vrarë shefin e bandës rivale [R.D]. (...)”.*

19. Më 1 shkurt 2018, Gjykata Themelore e Prishtinës nxori aktgjykimin e saj (PKR 375/14) kundër N.K. dhe e shpalli fajtor për një pikë të aktakuzës, por e liroi atë nga pikat që lidhen me pjesëmarrjen në një Grup të Organizuar Kriminal së bashku me persona të tjerë, përfshirë ankuesin.

20. Më 2 shkurt 2018, prokurori i EULEX-it i caktuar për rastin mori pjesë në një program televiziv të quajtur “Drejtësia në Kosovë”. Në këtë program, prokurori i EULEX-it u intervistua, së bashku me një numër personash të tjerë që ishin përfshirë në gjykim.

#### **Deklaratat e prokurorit të EULEX-it në intervistë**

21. Gjatë intervistës, prokurori i EULEX-it poashtu përmendi ankuesin. Këtu vijon një fragment:

[...]

**Intervistuesi:** *Prokuror, një nga proceset gjyqësore më të gjata në historinë e gjykimeve në Kosovë ka përfunduar sot, gjykimi kundër [N.K.]. Ai u dënua me gjashtë vjet burg me aktgjykimin e Gjykatës. Si prokuror, a jeni të kënaqur me këtë vendim dhe cili është mendimi juaj për të?*

**Prokurori i EULEX-it:** *Si prokuror për rastin, unë isha i kënaqur që ky i pandehur ishte dënua për një akuzë për trafikim droge, por gjithashtu isha i zhgënjyer që ai nuk ishte dënua për krim të organizuar dhe akuzat për vrasje të rëndë kundër viktimës me emrin [R.D.], i cili konsiderohej një komandant i madh lufte dhe një hero në Bosnjë gjatë luftës në Bosnje.*

**Intervistuesi:** *Një nga çështjet që gjykata përmendi sot është se dëshmitarët ranë në provim kur u pyetën nga mbrojtja. Cili mendoni se është problemi? A ishte sepse dëshmitarët u sfiduan, apo sepse ata kishin probleme me të kaluarën e tyre?*

**Prokurori i EULEX-it:** *Mendoj se është e rëndësishme të theksohet se para gjykimit dhe gjatë gjykimit shumë dëshmitarë tanë u kërcënuan me vdekje. Ne gjithashtu kishim dëshmi se disa prej tyre ishin korrumpuar, ose iu ishte ofruar ryshfet. Dhe për të depërtuar në një rrjet kriminal të mirë-organizuar shpesh ju duhet dhe mënyra e vetme që mund të depërtoni është që në një farë mënyre të bëni që një anëtar, ose anëtarë të organizatës të jenë të gatshëm të paraqiten. Dhe profili i këtyre njerëzve është në përgjithësi arsim i dobët, pa punësim, histori kriminale, dhe lehtësisht i korrumpuar, ose i bindur lehtë nga kërcënimet. Është si krimi klasik i organizuar në Itali i quajtur “Omerta”. Quhet kodi i heshtjes. Nëse thyni kodin e heshtjes, ne do t’ju vrasim, ose do të vrasim familjen tuaj,*

ne do të shkatërrojmë pronën tuaj, ne do të prishim reputacionin tuaj. Dhe ky ishte një rast ku kishte një histori njerëzish të vrarë, makina të tyre të bombarduara, granata të hedhura, media që i shkatërronin ata, në mënyrë që ata të mos gjenin punë. Kështu që ju keni dëshmitarë që patjetër mund të tundohen të ndryshojnë historinë e tyre, dhe kështu. [...] Por kur keni një akuzë serioze si vrasje ose krim i organizuar, kjo është barrë e prokurorisë. Ne duhet të përballojmë barrën dhe ajo duhet të jetë një barrë e madhe, për shkak të një krimi kaq të rëndë. Dhe gjykatësi mendoj se ne nuk e përballuam këtë barrë. Dhe, nuk jam dakord. Por, natyrisht, unë respektoj vendimin e gjykatës. Dhe kjo është arsyeja pse ne kemi një proces apelimi, dhe unë do ta bëj apelimin.

**Intervistuesi:** Janë përmendur përpjekjet për ryshfet të dëshmitarëve, kërcënime dhe kanosje. Nëse keni ndonjë dëshmi, a duhet t'i hetoni këto raste?

**Prokurori i EULEX-it:** Jo vetëm që ka prova të mjaftueshme, në fakt tani po zhvillohet një gjykim në Bosnjë kundër tre të pandehurve, të cilët akuzohen për frikësimin dhe kërcënimin e një prej dëshmitarëve tanë më të rëndësishëm në gjykimin tonë. Një nga emrat e të pandehurit është [ankuesi] dhe ai po ndiqet penalisht në Bosnjë tani, së bashku me dy shokët e tij të ngushtë për kërcënimin dhe frikësimin e një dëshmitari tonë. Pra, po, përgjigjja e pyetjes suaj është po, ka prova të mjaftueshme dhe ka një proces gjyqësor në lidhje me këta të pandehur për më shumë se një vit.

**Intervistuesi:** Ju thoni se krimi në Ballkan është i ngjashëm me atë në Itali. Kush është shefi dhe a punon ai nga rrjeti kriminal në Ballkan?

**Prokurori i EULEX-it:** Epo, në aktakuzën tonë ne pretendojmë se [ankuesi] urdhëroi vrasjen e [R.D.], dhe se i pandehuri [N.K.] është një ushtar besnik dhe një person i rangut të lartë në këtë grup të organizuar kriminal, gjeti vrasësit dhe ata kryen një atentat shumë mirë të ekzekutuar, një vrasje brutale të kësaj viktime. Nëse grupi i organizuar kriminal vazhdon ende, nuk e di. Por sigurisht që është një mundësi. [...]

**Intervistuesi:** Rasti u hetua kryesisht në Bosnjë. A është hetuar siç duhet dhe a janë dorëzuar të dhënat? Dhe a ishin provat e mjaftueshme apo mund të ishin hetuar më tej?

**Prokurori i EULEX-it:** Ishte një sfidë shumë e madhe që na u dha ky rast kur të gjitha provat, në thelb të gjitha provat dhe të gjithë dëshmitarët ishin në Bosnjë dhe Serbi, apo diku tjetër. [...] Dhe kështu kishim një sfidë të jashtëzakonshme sepse të gjitha dëshmitë tuaja dhe të gjithë dëshmitarët tuaj janë në Bosnjë. Ata i nënshtrohen kërcënimit dhe ryshfetit atje. Ata nuk kanë para, nuk kanë të ardhme. Ata kanë frikë për familjet e tyre. [Ankuesi] kishte perandorinë e tij mediale dhe një nga një, ai do të shkatërronte reputacionin e dëshmitarëve tanë në median e tij. Pra, kush dëshiron të dëshmojë? Kush është i gatshëm? Dhe ne madje kishim probleme për të marrë dosjen e plotë të lëndës. Bëra pesë udhëtime në Sarajevë për t'i marrë provat. Dhe, me kalimin e kohës, ne zhvilluam bashkëpunim me Bosnjën, por ishte shumë, shumë e vështirë.

**Intervistuesi:** Ju përmendët se [N.K.] erdhi në Kosovë për të shmangur gjykimin në Bosnjë. Çfarë mendoni, cili ishte objektivi i tij? Për të shmangur procesin dhe për të ardhur dhe për t'u gjykuar nga gjykata dhe një gjyqtar dhe një prokuror i financuar nga Bashkimi Evropian?

**Prokurori i EULEX-it:** Epo, e dini, në një farë mase po më kërkoni të spekuloj, por mbase ai kurrë nuk mendoj se do të arrestohej në Kosovë. Dhe për tetë muaj ai nuk ishte arrestuar. Dhe nëse ai nuk do të ishte arrestuar, mendoj, ai ende do të fshihej në Kosovë. Pra, nuk e di. Unë nuk mund t'ju them se çfarë ndodh në mendjen e tij, por ne i qëndrojmë aktakuzës sonë dhe besojmë se ai ishte përfshirë në këtë vrasje brutale.

[...]

### **Veprimi fillestar i ankuesit**

22. Më 8 shkurt 2018, ankuesi i shkroi kryeprokurorit të EULEX-it ankesë për deklaratat e dhëna nga prokurori i EULEX-it në intervistë.
23. Ankuesi i është referuar në mënyrë specifike një aktvendimi të kryetarit të Gjykatës Themelore të Prishtinës (PPKR 86/13) të datës 4 dhjetor 2014, duke urdhëruar, *ndër të tjera*, që,

*“Paraqitja dhe publikimi i akuzave kundër të pandehurit [N.K.] në tekstin e mëtejshëm nuk do të përfshijë emrat e personave që pretendohen nga prokuroria si bashkëkryerës jo i paditur në aktakuzën PPS 42/13. Kjo përfshin si formën verbale dhe të shkruar”.*

24. Ankuesi gjithashtu iu referua Vendimit dhe Gjetjeve të datës 19 tetor 2016 të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në lëndën nr. 2014-37, i cili kishte konstatuar shkelje të të drejtave të ankuesit sipas nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe i kishte bërë rekomandimet e mëposhtme ShM-së të EULEX-it:

- a. *ShM-ja duhet të bëjë një deklaratë duke pranuar se rrethanat e rastit përbënin një shkelje të të drejtave të ankuesit që i atribuohen veprimeve të EULEX-it në kryerjen e mandatit të tij ekzekutiv;*
- b. *ShM-ja duhet t'i sigurojë kopjen e këtij vendimi prokurorëve të EULEX-it përmes kanaleve përkatëse. Kjo duhet të shërbejë për të informuar prokurorët e EULEX-it për natyrën e përgjithshme të një obligimi për ta bërë prioritet mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të jo vetëm të dyshuarve dhe të akuzuarve, por edhe personave të tjerë të përfshirë në rastet që ata hetojnë.*

(Shih: [Decision and findings 2014-37-a.pdf \(hrrp.eu\)](http://hrrp.eu))

25. Ankuesi në ankesën e tij më 8 shkurt 2018 kërkoi që masat e mëposhtme të zbatohen nga kryeprokurori i EULEX-it:

- *Së pari*, për t'i kërkuar falje publike [ankuesit], e cila shpjegon qartë se:
  - *[Ankuesi] nuk është i dyshuar ose i pandehur në rastin [N.K.]; dhe*
  - *Nuk ka pasur asnjë përcaktim gjyqësor se [ankuesi] ishte përfshirë në vrasjen e supozuar të [R.D.] dhe Gjykata Themelore e Prishtinës e liroi [N.K.] nga vrasja e pretenduar e [R.D.].*
- *Së dyti*, të kërkojë nga BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese) të tërheqë artikullin e vet në lidhje me [N.K.], ose të fshijë çdo referencë ndaj [ankuesit] dhe të tërheqë autorizimin për çdo video që është në dispozicion në faqe të tjera; dhe
- *Së treti*, në bazë të shkeljes së hapur të [prokurorit të EULEX-it] të një urdhri mbrojtës të Gjykatës dhe direktivave të përcaktuara nga Paneli [për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut], të tërhiqet [prokurori i EULEX-it] nga rasti [N.K.] dhe të caktohet një prokuror, i cili është udhëzuar siç duhet për rëndësinë e respektimit të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtave të personave të tretë të përfshirë në rastin [N.K.].

26. Me letrën e datës 12 shkurt 2018, kryeprokurori i EULEX-it hodhi poshtë ankesat. Në mënyrë të veçantë, kryeprokurori i EULEX-it u shpreh, ndër të tjera, se,

*"[...] Asgjë nga ajo që u tha nga [prokurori i EULEX-it] gjatë intervistës nuk është e panjohur për publikun ose e ndryshme nga ajo që [u] propozua nga prokurori i lëndës gjatë gjithë procedurës penale.*

*Gjatë intervistës [prokurori i EULEX-it] përshkroi në terma të përgjithshëm kërcënimet dhe ofertat e ryshfetit që një numër dëshmitarësh në rastin që dyshohet se kanë marrë para dhe gjatë gjyqimit, shpjeguan fenomenin sociologjik që qëndron pas refuzimit për të dëshmuar dhe mohimin e deklaratave të mëparshme nga disa dëshmitarë në kontekste të caktuara dhe iu përgjigjën pyetjes së gazetarit në lidhje me provat e frikësimit të dëshmitarëve.*

*Në lidhje me këtë të fundit, ekzistenca e një procesi gjyqësor që po vazhdon në Bosnjë gjatë një viti kundër tre të pandehurve dhe që kanë të bëjnë me akuzat për kanosje të njërës prej dëshmitarëve të akuzës në rastin PPKR 86/13 u përmend gjatë intervistës.*

*E megjithatë, në asnjë pjesë të intervistës nuk gjeta ndonjë deklaratë të [prokurorit të EULEX-it] se të pandehurit në atë gjykim janë fajtorë ose se ata do të shpallen fajtorë. [...]*

*Bazuar në atë që u përmend më sipër, unë nuk gjej në intervistën e dhënë nga [prokurori i EULEX-it] ndonjë qëllim për të shpifur për të pandehurit në rastin që po zhvillohet në Bosnjë dhe/ose për të vënë në pikëpyetje të drejtën për prezumimin e pafajësisë që ata gëzojnë. [...]*

*[...] Në lidhje me kërkesën tuaj për të miratuar masa për të ruajtur prezumimin e pafajësisë dhe reputacionin e [ankuesit], unë konsideroj se deklaratat e bëra nga [prokurori i EULEX-it] gjatë intervistës (1) lidhur me ekzistencën në Bosnjë të procedimet penale kundër tre të pandehurve për kanosje të pretenduar të dëshmitarit të prokurorisë dhe (2) për rolin e pretenduar të luajtur nga [ankuesi] në vrasjen e pretenduar të [R.D.] nga [N.K.] u dhanë pa asnjë qëllim për të paragjykuar prezumimin e pafajësisë (e para) dhe reputacionin (e dyta) e [ankuesit]. [...]*

*Megjithatë, më duket se mënyra se si është përpiluar aktakuza, lëshimi i mëvonshëm i urdhrës nga kryetari i trupit gjykues dhe shqetësimi legjitim i ngritur në letrën tuaj e bën të nevojshme që të hiqet çdo dyshim në lidhje me pozicionin procedural të [ankuesit] në rastin PPKR 86/13 (PPS 42/13)".*

27. Më 14 shkurt 2018, si pasojë e konsideratave të shprehura në letrën e tij, kryeprokurori i EULEX-it lëshoi njoftimin për shtyp si në vijim:

**"Prishtinë, 14 shkurt 2018** - Në lidhje me intervistën e transmetuar më 2 shkurt 2018 me programin televiziv "Drejtësia në Kosovë" dhe që ka të bëjë me vendimin e fundit të gjykatës në rastin kundër [N.K.], Zyra e Prokurorisë e EULEX-it dëshiron të sqarojë se në asnjë moment gjatë procedurës penale para Gjykatës Themelore të Prishtinës [ankuesi] nuk ishte i pandehur dhe se nuk ka pasur asnjë vendim gjyqësor që [ankuesi] ishte përfshirë në ndonjë mënyrë në vrasjen e pretenduar të [R.D.]".

### III. ANKESA

28. Ankuesi pretendon se veprimet e prokurorit të EULEX-it kanë shkelur të drejtat e tij në dhënien e deklaratave publike që krijuan përshtypjen se:

- a. Ankuesi u padit për vrasje në rastin kundër N.K.;
- b. Është vërtetuar faktikisht se ankuesi është gjetur të jetë përgjegjës për akte të rënda të kanosjes së dëshmitarëve, përfshirë kërcënimet me vdekje.

29. Ankuesi pretendon se këto veprime:

- a. Kanë shkelur prezumimin e tij të pafajësisë siç mbrohet nga neni 6(2) i KEDNj-së; dhe
- b. ka shkelur të drejtën e tij për jetë private duke dëmtuar reputacionin e tij sipas nenit 8 të KEDNj-së.

30. Ankuesi pretendon se serioziteti dhe dëmi i shkaktuar nga këto shkelje janë përkeqësuar më tej nga:

- a. Fakti që prokurori i EULEX-it ishte udhëzuar më herët nga gjyqtari i Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut se deklarata të tilla do të minonin mbrojtjen dhe sigurinë e ankuesit dhe do të shkelnin të drejtat e tij sipas nenit 8 të KEDNj-së; dhe
- b. Dështimi i Misionit për t'i respektuar plotësisht direktivat e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut për të ndërmarrë hapa të veçantë për të siguruar që prokurorët e EULEX-it nuk kanë kryer shkelje të mëtejshme të të drejtave të ankuesit dhe për të lëshuar një deklaratë që do të kishte ndihmuar në rikthimin e reputacionit të ankuesit.

31. Ankuesi kërkon që ShM-ja të ftohet që:

- a. Të udhëzojë shefin e PSRK-së që të tërheqë prokurorin në fjalë, i cili është përgjegjës për shkeljet në rritje të drejtave të ankuesit, nga rasti në vazhdim kundër N.K.; dhe
- b. T'i kërkojë falje publike ankuesit për shkeljen e të drejtave të tij siç është përcaktuar më sipër.

#### **IV. KËRKESË PËR MASË TË PËRKOHSHME**

32. Ankuesi pohon se masat e përkohshme janë të nevojshme për të siguruar që e drejta e tij për një gjykim të drejtë në procedurat në Sarajevë të mos paragjykohet më tej përmes veprimeve të EULEX-it.

33. Për këtë qëllim, ankuesi kërkon që Paneli të urdhërojë autoritetet e prokurorisë së EULEX-it që:

- a. të nxjerrin një udhëzim të brendshëm në lidhje me atë që asnjë prokuror i EULEX-it nuk duhet t'i referohet ankuesit në deklaratat e tyre publike, ose procedurave në vazhdim në Sarajevë në lidhje me ankuesin;
- b. të kërkohet nga BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese) të tërheqë artikullin e tij në lidhje me N.K. që i referohet deklaratave të prokurorit të EULEX-it ose të fshihet çdo referencë ndaj ankuesit dhe të tërheq autorizimin për çdo video që është në dispozicion në faqet e tjera; dhe
- c. të lëshohet një deklaratë që mund të komunikohet nga ankuesi tek autoritetet përkatëse në Sarajevë, me qëllim që deklaratat e prokurorit të EULEX-it të mos konsiderohen si ndonjë pasqyrim i saktë i gjetjeve dëshmuese të Gjykatës Themelore në rastin kundër N.K.

## V. VLERSIMI I PANELIT I KËRKESËS PËR MASË TË PËRKOHSHME

34. Paneli rikujton rregullën 22. Masat e përkohshme, paragrafi 1, të rregullores së tij të punës:

*“Paneli, ose kur është e përshtatshme, kryesuesi i tij, me kërkesë të ankuesit, ose sipas gjykimit të tij, mund t’i propozojë ShM-së që një masë e përkohshme e konsideron të nevojshme të zbatohet në interes të zhvillimit të duhur të procedurave para tij. SHM-ja do të marrë një vendim”.*

35. Paneli vëren se rregulla 212(1) parasheh që Paneli mund t’i “propozojë një masë të përkohshme” ShM-së dhe nuk mund të lëshojë “urdhra” për EULEX-in ose anëtarët e stafit të tij.
36. Paneli thekson më tej se mandati ekzekutiv i EULEX-it në sistemin e drejtësisë në Kosovë ka përfunduar më 14 qershor 2018.
37. Në ndërkohë, siç u theksua në parashtrimet e ShM-së për pranueshmërinë më poshtë, procedurat gjyqësore kundër ankuesit në Bosnjë dhe Hercegovinë në lidhje me akuzën e kanosjes së dëshmitarëve, përfundimisht kishin marrë në një aktgjykim të Kolegjit të Apelit më 25 tetor 2018.
38. Si pasojë, Paneli konstaton se kërkesa e ankuesit për propozimin e një mase të përkohshme është bërë e parëndësishme.
39. Prandaj, Paneli refuzon kërkesën e ankesës për propozimin e një mase të përkohshme.

## VI. PARASHTRIMET E PALËVE LIDHUR ME PRANUESHMËRINË

### Ankuesi

40. Siç u përmbledh më lart, ankuesi pretendon se prokurori i EULEX-it i caktuar për procedural penale kundër N.K. kishte bërë deklarata publike në një intervistë televizive që shkelnin të drejtat e ankuesit për prezumimin e pafajësisë në lidhje me procedimet penale kundër tij në Bosnjë dhe Hercegovinë, të mbrojtura nga neni 6(2) i KEDNj-së. Për më tepër, ankuesi pretendon se e drejta e tij për respektimin e jetës së tij private siç mbrohet nga neni 8 i KEDNj-së është shkelur për shkak të dëmtimit të reputacionit të tij të shkaktuar nga deklaratat e prokurorit të EULEX-it.
41. Lidhur me nenin 6(2) të KEDNj-së, ankuesi pohon se ky nen do të shkelej nëse një zyrtar publik përdor një gjuhë që do të inkurajojë publikun të besojë se një i dyshuar është fajtor, ose të paragjykojë ndryshe vlerësimin e fakteve nga gjykata kompetente (shih: Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 24 prill 2008, *Ismoilov dhe të tjerët kundër Ruisë*, nr. 2947/06, paragrafi 61; Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 26 mars 2002, *Butkevičius kundër Lituanië*, nr. 48297/99, paragrafi 53).
42. Ankuesi parashtron më tej se detyra për të respektuar prezumimin e pafajësisë zbatohet gjithashtu për deklaratat që kanë një lidhje të ngushtë me procedurat penale që zhvillohen në një juridiksion tjetër. Edhe pse procedimet kundër ankuesit për pengim të drejtësisë po zhvillohen në Bosnjë, këto procedura janë të lidhura ngushtë me rastin kundër N.K. që po zhvillohen në Kosovë. (Shih: Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 24 prill 2008, *Ismoilov dhe të tjerët kundër Ruisë*, nr. 2947/06, paragrafi 163).



43. Ankuesi pretendon se me deklaratat e tij, prokurori i EULEX-it shkoi përtej asaj që vetëm të pretendonte një dyshim se ankuesi ishte përfshirë në kanosjen e dëshmitarëve, por gjithashtu pretendoi se ankuesi ishte pjesë e një organizate kriminale dhe e përshkroi atë në termat që sugjerorin se ishte një fakt i vërtetuar.
44. Lidhur me nenin 8 të KEDNj-së, ankuesi parashtron se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka përcaktuar se kjo e drejtë përfshin mbrojtjen e reputacionit të një personi, për sa kohë që *“publikimi përbën një sulm të drejtpërdrejtë ndaj jetës private të një personi të një rëndësie të tillë që të komprometojë integritetin e tij personal”* (Shih Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 21 shtator 2010, *Polanco Torres dhe Movilla Polanco kundër Spanjës*, nr. 34147/06, paragrafi 40).
45. Ankuesi parashtron se deklaratat e prokurorit të EULEX-it në lidhje me ankuesin përbëjnë një sulm të rëndë ndaj reputacionit të tij. Deklarata e prokurorit të EULEX-it se aktakuza pretendonte se ankuesi kishte urdhëruar N.K. për vrasjen e R.D. krijoi përshtypjen se ankuesi ishte akuzuar zyrtarisht për vrasje dhe kundërshtoi gjetjet e Gjykatës Themelore të Prishtinës, e cila e kishte liruar N.K. për vrasjen e R.D.
46. Për më tepër, me deklaratat e tij, prokurori i EULEX-it kundërshtoi aktvendimin e kryetarit të Gjykatës Themelore të Prishtinës të datës 44 dhjetor 2014 për t'u përmbajtur nga përmendja e emrit të ankuesit në lidhje me aktakuzën.
47. Ankuesi gjithashtu kujtoi vendimin e Panelit në lëndën nr. 2014-37, ku Paneli kishte gjetur se deklarata të tilla si ato të bëra nga prokurori i EULEX-it *“[ishin] në gjendje ta stigmatizonin atë dhe të kishin një ndikim të madh në të jetën personale dhe reputacionin e tij”*. (Shih: Y.B. kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet e datës 19 tetor 2016, par. 53).
48. Ankuesi më tej parashtron se dështimi i ShM-së për të *“bërë një deklaratë duke pranuar se rrethanat e rastit përbënin një shkelje të të drejtave të ankuesit”*, siç rekomandohet nga Paneli në vendimin e tij të lartpërmendur, ka nënkuptuar se dëmtimi i reputacioni i ankuesit është rritur.

### **Shefi i Misionit (“ShM”)**

49. Në vërejtjet e tij mbi ankesën, ShM-ja parashtrroi se,

“[...] Ka arsye të mjaftueshme që ankesa të hiqet nga lista e ankesave në përputhje me rregullën 29 e *tutje* të rregullores së punës të Panelit, sepse ankesat e përfshira në të kanë të bëjnë veçanërisht me nenin 6(2) dhe nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë zgjidhur plotësisht që nga paraqitja e ankesës në shkurt të vitit 2018“.

### **Zbatimi i rregullës 22 e *tutje* të rregullores së punës së Panelit**

50. Misioni vuri në dukje se ankesa mban datën 13 shkurt 2018 dhe se ankesa iu komunikua ShM-së për vërejtjet e tij më 22 mars 2019. Misioni parashtron se në periudhën midis atëherë kur ishte parashtruar rasti në fillim dhe komunikimit të tij tek ShM-ja kanë ndodhur një numër zhvillimesh të rëndësishme.
  - a. Së pari, më 14 qershor 2018, mandati ekzekutiv i EULEX-it në sistemin e drejtësisë në Kosovë përfundoi dhe të gjitha funksionet prokuroriale dhe juridiksionale të Misionit përfunduan në atë datë, duke çuar në largimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve ndërkombëtarë nga Misioni. Sipas këtij zhvillimi, kërkesa e ankuesit, *“Të udhëzojë kryetarin e PSRK-së që të tërheqë*

*prokurorin në fjalë, i cili është përgjegjës për shkeljet në rritje të të drejtave të ankuesit, nga lënda në vazhdim e sipër kundër N.K”, është bërë jorelevante.*

- b. Së dyti, më 25 tetor 2018, Kolegji i Apelit i Gjykatës së Bosnjës dhe Hercegovinës (BH) dha një vendim apeli në rastin e ankuesit dhe të tjerëve, duke hedhur poshtë si të pabazuar ankesën e paraqitur nga Zyra e prokurorit të BH, dhe duke lënë në fuqi aktgjykimin e dhënë nga Gjykata e BH më 16 maj 2018 që e liron ankuesin nga akuzat. Prandaj, Misioni parashtron se është e qartë se asnjë ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për një gjykim të drejtë nuk ka ndodhur ndonjëherë. Tre muaj pas transmetimit të programit televiziv, ankuesi u lirua nga një gjykatë e shkallës së parë dhe pastaj pesë muaj më vonë nga një vendim përfundimtar i gjykatës.
- c. [...]
- d. Së katërti, në përgjigje të letrës së ankuesit të 8 shkurtit 2018, më 14 shkurt 2018, Misioni përmes zyrës së kryeprokurorit të shtetit të Kosovës, lëshoi një sqarim për shtyp duke theksuar se, “[...] asnjëherë gjatë procedurave penale pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës [ankuesi] nuk ishte i pandehur dhe se nuk ka pasur ndonjë vendim gjyqësor që [ankuesi] ishte përfshirë në çfarëdo mënyre në vrasjen e pretenduar të [R.D.]”.

51. Sipas këtij informacioni, Misioni parashtron se të gjitha çështjet e pretenduara në ankesë janë zgjidhur, dhe se, prandaj, ankesa duhet të hidhet poshtë nga Paneli në përputhje me rregullën 29 e *tutje*, paragrafi 1(b), i rregullores së punës.

#### **Ankesa qartazi e pabazuar**

- 52. Përndryshe, nëse Paneli vendos të mos e heq ankesën nga lista e ankesave, pjesërisht ose plotësisht, Misioni parashtron që ankesa duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar.
- 53. Misioni parashtron se deklaratat e dhëna nga prokurori i EULEX-it gjatë programit televiziv “*Drejtësia në Kosovë*” më 2 shkurt 2018 nuk mund të konsiderohen si kërcënim për prezumimin e pafajësisë në lidhje me procedurat gjyqësore në Bosnjë dhe Hercegovinë, as sulm serioz mbi reputacionin e ankuesit që arrin një shkelje të së drejtës së tij për respektimin e jetës së tij private, siç mbrohet nga neni 8 i KEDNj-së.
